
DISKRIMINIMI DHE DHUNA ME BAZË ORIENTIMIN SEKSUAL DHE IDENTITETIN GJINOR

**PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE TË PYETËSORIT ME
ANËTARË TË KOMUNITETIT LGBTI+**



© ALEANCA LGBT

DISKRIMINIMI DHE DHUNA ME BAZË ORIENTIMIN SEKSUAL DHE IDENTITETIN GJINOR

Ky raport përmbledhës synon të sjellë një panoramë të gjetjeve të analizuara nga të dhënat e pyetësorit online “Diskriminimi dhe dhuna me bazë orientimin seksual dhe identitetin gjinor”, zhvilluar nga Aleanca kundër diskriminimit LGBT.

Sondazhi u plotësua nga 295 individë të vetëidentifikuar si LGBTI+, një kampion që e bën këtë raport mjaft relevant në përcjelljen e zërit dhe problematikave aktuale të vetë komunitetit.

Pyetësori u publikua në rrjetet sociale gjatë muajit Tetor 2020 dhe përgjigjet u regjistruan deri në fundin e Dhjetorit 2020. Sondazhi kishte për qëllim të maste nivelin e diskriminimit dhe dhunës që përjetojnë personat e komunitetit LGBTI, duke shqyrtuar situatat e përditshme të komunitetit në raportet familjare, të punësimit, ato me institucionet shtetërore, ofruesit e shërbimeve, mekanizmat e referimit të rasteve dhe njohuritë mbi korpusin juridik për mbrojtjen nga dhuna dhe diskriminimi me bazë orientimin seksual dhe identitetin gjinor.


Disa nga gjetjet më të rëndësishme të pyetësorit tonë konsistuan në këto përfundime:

- Afro 98% e të anketuarve raportojnë se gjatë vitit të fundit janë ndeshur me ofendime, tallje e poshtërim të vazhdueshëm për shkak të orientimit seksual/identitetit gjinor/karakteristikave dhe shprehive të seksit. 72.2% e të anketuarve raportojnë incidente të rënda si pasojë e diskriminimit për shkak të statusit LGBTI+ që arrijnë deri në sulme me armë dhe sende të forta;
- 43.7% raportojnë se kanë qenë objekt diskriminimi nga rrethi i ngushtë social;
- Ambientet me numrin më të lartë të incidenteve me bazë diskriminimin për shkak të statusit LGBTI+ mbeten mjediset e institucioneve të edukimit në një përqindje prej 46.4% të raportimeve nga të anketuarit, ndjekur nga rastet e diskriminimit dhe dhunës të iniciuara online apo në ëebsite takimesh në 32% të rasteve;
- Vijohet të raportohet diskriminimi në zyrat e shtetit apo në institucionet që ofrojnë shërbime parësore në afro 8% të rasteve;
- 21.4% e të përgjigjurve pohojnë se janë ngacmuar seksualisht dhe janë prekur pa dëshirën e tyre për shkak të statusit të tyre LGBTI+, 5.2% e këtyre rasteve raportohen në familje;
- Vetëm 7.1% e të anketuarve i kanë raportuar institucionalisht incidentet e ndodhura, nga të cilët vetëm 5.8% në Polici. Edhe pse kjo përqindje raportimi është shumë e ulët, vetëm 20.3% e rasteve të referuara kanë marrë zgjidhje;
- Mbetet evidente kultura e mosraportimit dhe ërheqjes nga adresimi i rasteve për shkak të frikës nga paragjykimi, mungesës së besimit te institucionet shtetërore në afro 6% të rasteve dhe presionit për t'u tërhequr;
- 142 individë të anketuar u shprehën se u besonin më tepër organizatave për të drejtat LGBTI+ dhe se janë më të prirur ta referojnë rastin në këto organizata sesa në institucionet përkatëse;
- 45.1% e të përgjigjurve vijnë të jenë të painformuar mbi ekzistencën e ligjeve që i mbrojnë nga diskriminimi dhe dhuna me bazë statusin e tyre LGBTI+; 79% e personave LGBTI+ të anketuar u shprehën se dëshirojnë të largohen nga Shqipëria, pasi nuk ndjehen të sigurt dhe të lirë për të gëzuar një jetesë normale, në kushtet e nivelit të lartë të diskriminimit, ekzistencës së vakumeve ligjore jo favorizuese, nivelit të lartë të papunësisë në radhët e komunitetit dhe aksesit në shërbime.

Analizimi i të dhënave të pyetësorit

Nga të dhënat e mbledhura në pyetësorin tonë, na rezultoi se nga 295 të përgjigjur, 144 pjesëmarrës (afro 48.8%) i përkasin grupmoshës 13-20 vjeç, ndërsa 119 prej tyre (afro 40.3 %), i përkasin grupmoshës 20-35 vjeç. Vetëm 7.8% e të përgjigjurve i përkasin grupmoshës 35-45 vjeç.

1. Moshë:
295 responses




Pjesa dërmuese e të anketuarve (afro 50%) jetojnë në qytetin e Tiranës, ndjekur nga një numër i konsiderueshëm i pjesëmarrësve nga qytete si Durrësi, Elbasani, Vlora, Shkodra, Fieri, Laçi e Lezha.

Pjesa kryesore e të përgjigjurve (afro 33.2%) rezulton të ketë përfunduar arsimin e mesëm të përgjithshëm, ndjekur nga të anketuarit që kanë përfunduar arsimin e lartë dhe Master (afro 28.8% dhe 11.5%). 14.2% e të përgjigjurve kanë përfunduar vetëm arsimin e detyrueshëm 9-vjeçar, ndërsa 7.5% e totalit të pjesëmarrësve kanë përfunduar arsimin profesional. Mbeten shqetësuese shifrat e të anketuarve që raportojnë të mos kenë përfunduar as ciklin e detyrueshëm të edukimit, të cilët zënë rreth 3.8% të totalit të pjesëmarrësve në këtë pyetësor.



3. Ju lutemi shënoni nivelin arsimor që keni përfunduar apo jeni duke kryer:


295 responses



Në kuadër të statusit civil aktual, 234 të anketuar ose afro 79.3% janë të pamartuar, 8.8% e tyre janë të martuar, 6.1% deklarojnë se janë në një bashkëjetesë, ndërsa 5.8% janë të ve.

4. Statusi civil:

295 responses




Nga ky pyetësor rezulton se të papunët në radhët e komunitetit zënë masën më të madhe të të anketuarve në një masë 60.7%, në raport me vetëm 39.3% të punësuar LGBTI+.



4.1. A jeni aktualisht në punë?

295 responses




Të pyetur se me kë jetonin aktualisht, pjesa dërrmuese e të anketuarve, në një masë prej 74.9%, deklaruan se jetojnë me familjet. Vetëm 13.9% deklaruan një jetesë të pavarur, vetëm apo me partnerët respektivë (5.4%). 4.7% e të anketuarve jetojnë me miqtë.

23.1% e të përgjigjurve identifikohen si vajza/gra biseksuale, 22.4% identifikohen si burra/djem gej, 21.7% identifikohen si djem/burra biseksualë dhe 9.5% e të anketuarve identifikohen si lesbike. Është mjaft interesante përqindja e pjesëmarrësve të vetëidentifikuar si interseks, në një masë prej 6.8% ose 20 individë, çka e bën këtë pyetësor një nga mjetet e rëndësishme të përcjelljes së zërit të individëve interseks, të cilët janë vështirë të arritshëm mes mjeteve të përdorura tradicionalisht për mbledhjen e të dhënave. Vetëm 4.1% e të anketuarve identifikohen si transgjjinorë, ndërkohë që përqindja e mbetur, në një masë të vogël identifikohen si aseksualë, panseksualë dhe si individë me gjini jo binare.


6. Si e identifikoni veten:

295 responses



Të pyetur nëse kishin dalë hapur lidhur me orientimin seksual/identitetin gjinor/karakteristikat dhe shprehitë e seksit, në një masë prej 64.7%, të anketuarit përgjigjen negativisht. Vetëm 35.3% e të anketuarve pohojnë të kenë dalë hapur te të afërmit apo familjarët e tyre.

7. A keni dal hapur në lidhje me orientimin seksual/identitetin gjinor?
295 responses




❖ Incidente lidhur me Orientimin Seksual/Identitetin Gjinor/Karakteristikat dhe Shprehitë e Seksit

Të pyetur lidhur me përballjen me incidente të ndryshme për shkak të statusit LGBTI+, të anketuarit raportojnë nivele të larta të rasteve të diskriminimit të formave të ndryshme. Nga një analizë e thjeshtë e të dhënave të këtij pyetësi, situata paraqitet shqetësuese, ku afro 98% e të përgjigjurve raportojnë ofendime, tallje e poshtërim të vazhdueshëm për shkak të statusit të tyre LGBTI+. 129 të anketuar apo 43.7%, pohojnë të kenë qenë objekt talljeje nga rrethi i ngushtë shoqëror, ndërkohë që pjesa tjetër raportojnë përballjen e vazhdueshme me situata diskriminuese si shmangie në publik, trajtim jo i barabartë apo thashetheme dashakeqëse. Disa të anketuar raportojnë se me të dalë hapur si LGBTI+ janë përballur me izolim, janë shantazhuar, madje edhe arrestuar, në cënim të të drejtave dhe lirive të tyre themelore. Vetëm 2% e totalit të të përgjigjurve pohojnë se nuk janë përballur me situata diskriminuese, duke theksuar faktin se nuk kanë dalë hapur si LGBTI+.



8. A ju ka ndodhur që për shkak të orientimit seksual/identitetit gjinor t'u: (mund të zgjidhni më shumë se një alternativë)

295 responses




❖ Ambienti ku ka ndodhur incidenti

Ndërkohë që 98% e të anketuarve raportojnë përballjen me situatë diskriminuese për shkak të statusit të tyre LGBTI+, të pyetur për vendin/ambientin ku kanë ndodhur këto incidente, 137 individë ose 46.4% të totalit të të anketuarve tregojnë se kanë qenë viktimë të diskriminimit në ambientet e shkollës apo universitetit, çka e bën situatën tejet shqetësuese. Ndër ambientet e tjera ku ndodhi incidenti, 29.5% e anëtarëve të komunitetit raportojnë për situatë diskriminuese në familje, 21.7% raportojnë diskriminim të afërmit, afro 32% raportojnë për diskriminim në






295 responses



apo tërhequr për shkak të statusit të tyre LGBTI+. 9.5% e të anketuarve raportojnë se kundrejt tyre është ushtruar dhunë në formën e rrahjes, ndërsa pjesa e mbetur raporton për forma alternative të dhunës, si largim nga vendi i punës, shkelmim, dëmtim, vjedhje, përzënie nga ambientet religjioze dhe tallje.

9. A ju ka ndodhur që për shkak të orientimit tuaj seksual/identitetit gjinor t'u: (mund të zgjidhni më shumë se një alternativë)

295 responses



❖ Ambientet ku ndodhën incidentet e mësipërme

Të pyetur lidhur me ambientin ku ndodhi incidenti me pasojë të rëndë, të anketuarit u shprehën se në pjesën më të madhe, afro 66%, situata është iniciuar online. Në 11.5% të rasteve këto incidente raportohen të ndodhura në familje, ndërsa 12.2% raportojnë se janë përballuar me këto situata në ambientet e institucioneve të edukimit.

❖ Situata të tjera me të cilat përballen individët për shkak të statusit të tyre LGBTI+




Anëtarët e komunitetit raportojnë për situata ku janë ngacmuar seksualisht apo janë prekur pa dëshirën e tyre për shkak të statusit LGBTI+ në masën 21.4%. 16 të anketuar raportojnë se janë shfrytëzuar për të kryer marrëdhënie seksuale pa dëshirën e tyre për shkak të statusit LGBTI+. Afro 5% e të përgjigjurve pohojnë se janë dhunuar psikologjikisht, duke u detyruar të shikojnë materiale pornografike me force dhe pa pëlqimin e tyre. Të tjerë të anketuar raportojnë situata të rënda diskriminimi dhe dhune, ku përfshihet: detyrimi për të marrë substanca narkotike pa dëshirën e tyre, ngacmim apo dhunim i të afërmeve etj. Paraqitet veçanërisht shqetësues fakti, se situatat e përmendura në 5.1% të rasteve kanë ndodhur në familjet e të anketuarve, ku 3.7% e të afërmeve kanë qenë drejtpërdrejt të përfshirë në aktet e diskriminimit apo dhunës së ushtruar ndaj tyre.

❖ Raportimi i incidentit të ndodhur për shkak të Orientimit Seksual/Identitetit Gjinor/Karakteristikave dhe Shprehive të Seksit

Të pyetur nëse e raportuan apo jo incidentin e ndodhur për shkak të statusit LGBTI+, 35.9% e totalit të të përgjigjurve që kanë patur incidente tregojnë se nuk i kanë raportuar ato, përballë vetëm 7.1% të rasteve të raportuara.

11. A i/e keni raportuar incidentin/incidentet që kanë ndodhur për shkak të orientimit seksual/identitetit gjinor?
295 responses



Paraqitet mjaft shqetësues fakti se këto incidente nuk raportohen në mënyrë korrekte dhe pranë insitucioneve kompetente. Vetëm 17 të anketuar apo 5.8% nga totali i atyre që janë përballur me situata diskriminimi e kanë raportuar rastin e tyre në Polici dhe vetëm 9 persona apo 3.1% e kanë raportuar rastin në insitucionin e KMD-së. Pjesa dërrmuese e të anketuarve i kanë raportuar situatat e tyre pranë organizatave jo qeveritare që punojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të komunitetit LGBTI+, pasi theksojnë se kanë më tepër besim për raportimin dhe referimin e rastit



të tyre përmes këtyre organizatave. Mbetet ende mjaft evidente problematika e kulturës së mosraportimit/tërheqjes nga adresimi i rasteve nga ana e anëtarëve të komunitetit, çka shpie në pamundësinë e tyre reale për të përfituar nga garancitë ligjore në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

❖ Reagimi i institucionit/organizatës ku u raportua incidenti


Në rastet e pakta ku situata diskriminuese për shkak të statusit LGBTI+ u raportua nga anëtarët e komunitetit të anketuar, rezulton se vetëm 20.3% e tyre janë ndierë të mbështetur në procesin e referimit. 9 të anketuar shprehen se janë përballur me qëndrime armiqësore dhe me një ambient jo të rehatshëm kur kanë raportuar rastin e tyre të dhunës pranë institucionit kompetent, ndërsa 5.9% e tyre pohojnë se kanë ndeshur në qëndrime paragjyquese të zyrtarëve shtetërorë. Pjesa tjetër e pjesëmarrësve raportojnë se nuk kanë raportuar asnjëherë incidente lidhur me situatat e tyre apo të të njohurve të tyre.

❖ Procedimi i mëtejshëm i rasteve të raportuara

108 pjesëmarrës apo 36.6% e tyre shprehen se zgjodhën të mos e raportonin rastin e tyre. Sa i përket ndjekjes së rasteve të raportuara dhe vijueshmërisë së tyre, 149 të anketuar apo 50.5% e tyre shprehen se nuk kanë asnjë informacion të mëtejshëm pas raportimit fillestar të rastit. 21 prej anëtarëve të komunitetit të anketuar ose 7.1% e tyre, pohojnë se rasti nuk ka marrë ende zgjidhje paçka raportimit. Vetëm 13 individë apo 4.4% shprehen se rasti ka marrë zgjidhje, ndërkohë që 1.4% e totalit tregojnë se çështja është në proces e sipër dhe janë në pritje të një zgjidhjeje.

13.2 A ka marrë zgjidhje incidenti i raportuar:

295 responses



❖ Arsyet e mosraportimit

83 individë LGBTI+ ose 32.5% e pjesëmarrësve të këtij pyetësi kanë renditur si shkak për mosraportimin e situatës së dhunës/diskriminimit stepjen dhe frikën për të dalë hapur në raport me orientimin e tyre seksual/identitetin gjinor/karakteristikat dhe shprehjet e seksit, për shkak të paragjykit të potencial që mund të hasnin nga aktorët shtetërorë apo pasojave që mund të sillte në jetën e tyre ky vetë-ekspozim. Në vijim, mungesa e besimit në zgjidhjen nga institucionet ku prezumohet të adresohet rasti, u rendit si një shkak për mosraportim nga 23.5% e totalit të të anketuarve. Ngurrimi për të raportuar rezulton edhe nga eksperiencat që mund të kenë dëgjuar nga miqtë, mungesa e informacionit për procedurat që duhet të ndjekin apo nga pasja e një eksperiencë negative të mëparshme, ku institucionet nuk kanë dhënë zgjidhje.


❖ Format më të përshtatshme të raportimit

Të pyetur se me cilën formë potenciale të raportimit të rastit të diskriminimit/dhunës për shkak të statusit LGBTI+ ndjeheshin më komodë, vihet re një mungesë besimi nga ana e anëtarëve të komunitetit në institucionet shtetërore. Ndërkohë, 142 pjesëmarrës raportojnë se kanë më shumë besim ta referojnë rastin e tyre të dhunës pranë organizatave që mbrojnë të drejtat e personave LGBTI+. 48.1% e të anketuarve shprehen se do të ndjeheshin komodë ta raportonin rastin e tyre të dhunës në platformat online të vendosura në dispozicion nga këto organizata. Vetëm 81 prej anëtarëve të komunitetit do ta raportonin rastin e tyre të dhunës pranë Policisë apo te Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.



15. Cila nga format e raportimit të incidenteve të dhunës do të ishte më e përshtatshme për ju?

295 responses




❖ Informacioni lidhur me korpusin juridik për mbrojtjen nga diskriminimi

54.9% e të anketuarve shprehen se janë në dijeni të faktit që në Shqipëri ekzistojnë ligje që mbrojnë personat e komunitetit LGBTI+ nga diskriminimi mbi bazat e orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Ndërkohë, 133 prej tyre apo 45.1% pohojnë se nuk janë në dijeni të ekzistencës së këtyre ligjeve. Megjithëse në masën më të madhe raportojnë se njohin ekzistencën e akteve, vihet re se të anketuarit nuk njohin dhe nuk kanë lexuar përmbajtjen e akteve kryesore ligjore që mbrojnë të drejtat e tyre në masën 69.8%. Vetëm 19.3% e totalit të pjesëmarrësve pohojnë se njohin/kanë lexuar Ligjin Nr.10 221, datë 4.2.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi" dhe vetëm 16.6% e tyre shprehen se kanë dijeni/kanë lexuar "Planin Kombëtar të Veprimit për Personat LGBTI+ në Republikën e Shqipërisë".



16. Jeni në dijeni se në Shqipëri ekzistojnë ligje që mbrojnë personat e komunitetit LGBTI nga diskriminimi për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor?

295 responses



❖ Migracioni

Të pyetur nëse kanë menduar të largohen nga Shqipëria, 233 të anketuar LGBTI+ ose 79% e tyre u përgjigjën pozitivisht. Vetëm 21% e pjesëmarrësve në këtë pyetësor u shprehën se nuk e kishin menduar migrimin, tregues ky që dëshmon mbi vështirësitë me të cilat përballen anëtarët e komunitetit LGBTI+ gjatë jetesës së tyre në Shqipëri. Lidhur me arsyet që i nxisin të largoheshin nga Shqipëria, 210 të anketuar që përkojnë me 72.4% të totalit të tyre shprehen se nuk ndjehen të lirë duke jetuar në Shqipëri. 29% e pjesëmarrësve shprehen se nuk pranohen nga familja për shkak të orientimit seksual/identiteti gjinor/karakteristikave dhe shprehive të seksit, ndërkohë që 16.6% e totalit shprehen se duan të emigrojnë, pasi ndihen të diskriminuar nga institucionet shtetërore. Ndër shkaqet e tjera që i shtyjnë drejt emigrimit, anëtarët e komunitetit raportojnë vështirësinë për akses në edukim, shëndetësi, pamundësinë për të gjetur punë për shkak të orientimit seksual/ identiteti gjinor/karakteristikave dhe shprehive të seksit si dhe problemet e strehimit.



18. A keni menduar të emigroni?

295 responses

